



Instituti i Kosovës për Drejtësi
Kosovo Law Institute
Kosovski Institut Pravde

07/2025



EFIKASITETI GJYQËSOR NË PRAKTIKË DHE TË DREJTAT GJUHËSORE NË SISTEMIN GJYQËSOR

(ANALIZË E RASTEVE TË MONITORUARA NË DEPARTAMENTIN SPECIAL TË GJYKATËS THEMELORE NË PRISHTINË DHE
DEPARTAMENTIN E PËRGJITHSHËM NË GJYKATËN THEMELORE NË PRISHTINË – DEGA NË GRAÇANICË)

Autore: Magdalena Dimitrijević

Me kontribut të veçantë nga: Emilija Stanojević dhe Marina Kukureković

Redaktorë: Ehat Miftaraj, Arrita Reznqi, Gzim Shala dhe Igor Stojković

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet apo riprodhohet në çfarëdo forme, elektronike apo të shtypur, ose në ndonjë formë tjetër riprodhimi pa lejen e Institutit të Kosovës për Drejtësi. Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi ekskluzive e Institutit të Kosovës për Drejtësi dhe nuk pasqyron domosdo pikëpamjet e donatorit.

Realizuar nga:



KOSOVO LAW INSTITUTE
INSTITUTI I KOSOVES PER DREJTESI
KOSOVSKI INSTITUT PRAVDE

Rreth IKD-së

Instituti i Kosovës për Drejtësi është organizatë joqeveritare dhe jofitimprurëse e politikave publike, institut hulumtues i specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD

Rr. Ilaz Agushi, Prishtinë

E-mail: info@kli-ks.org

www.kli-ks.org

Qershor, 2025

Prishtinë,

Republika e Kosovës

Përmbajtja

1.	Përmbledhja ekzekutive.....	4
2.	Monitorimi i seancave gjyqësore në Departamentin Special të Gjykatës Themelore në Prishtinë	5
2.1.	Efikasiteti i gjykatës	5
2.2.	Pajisja me shkresa të lëndës.....	6
2.3.	Ndikimi i gjuhës dhe shërbimeve të përkthimit	7
3.	Monitorimi i seancave gjyqësore në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Dega në Graçanicë	7
3.1.	Efikasiteti i gjykatës	8
3.2.	Dërgimi i shkresave.....	10
3.3.	Ndikimi i gjuhës dhe shërbimeve të përkthimit	10
4.	Mbrojtja e të drejtave gjuhësore në sistemin e drejtësisë	10
4.1.	Problemet në cilësinë e përkthimit.....	11
4.2.	Mungesa e kapaciteteve	11
4.3.	Rëndësia e përkthimit të aktgjykimeve dhe komentareve.....	12
5.	Rekomandimet	13

1. Përmbledhja ekzekutive

Ky raport ofron një analizë të efikasitetit të procedurave gjyqësore dhe respektimit të të drejtave gjuhësore në Departamentin Special të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Dega në Graçanicë, bazuar në monitorimin e drejtpërdrejtë të 226 seancave gjyqësore të zhvilluara gjatë një periudhe shtatë mujore. Analiza fokusohet në çështjet ligjore dhe administrative që lidhen kryesisht me komunitetin serb në Kosovë, duke identifikuar sfida që ndikojnë në efikasitetin dhe integritetin e proceseve gjyqësore. Fokusi i hulumtimit trajton praktikatat procedurale dhe sfidat që ndikojnë në efikasitetin e procedurave gjyqësore para gjykatave.

Gjetjet nga monitorimi tregojnë se pengesat e vërejtura, përfshirë mangësitë teknike dhe procedurale, ndikojnë në dinamikën e procedurave gjyqësore dhe sigurinë juridike të palëve të përfshira.

Në Departamentin Special të Gjykatës Themelore në Prishtinë gjatë periudhës së monitorimit u monitoruan 97 seanca gjyqësore në raste të ndryshme, nga të cilat 16 u shtynë, që paraqet rreth 16.5% të numrit të përgjithshëm të rasteve të monitoruara. Analiza e arsyeve të shtyrjes tregon se shkaku më i shpeshtë ishte mungesa ose vonesa në përkthimin e shkresave të lëndës (13 raste). Një (1) rast tjetër u shty për shkak të mungesës së avokatëve mbrojtës ndërsa dy (2) raste u shtynë për shkak të mungesës së palëve të dëmtuara.

Në anën tjetër, në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Dega në Graçanicë, në total janë monitoruar 129 seanca gjyqësore, nga të cilat 18 u shtynë, duke përbërë rreth 14% të numrit total të seancave. Seancat e shtyra u evidentuan në 10 raste penale dhe 8 raste civile. Në procedurat penale, arsyeja më e shpeshtë për shtyrje ishte dorëzimi jo i rregullt i ftesave të palëve (6 raste). Përveç kësaj, në një (1) rast, seanca u shty për shkak të vonesës së prokurorisë në dorëzimin e dosjeve, ndërsa në tri (3) raste, të pandehurit mungonin për shkak se ishin jashtë vendit.

Një element kritik i identifikuar është edhe cilësia e përkthimit të shkresave të lëndës, e cila mund të ndikojë në efektivitetin e të drejtave të palëve në procedurë. Në veçanti, mungesa e kapaciteteve të mjaftueshme përkthyes shkakton edhe vonesa procedurale.


Raporti identifikon gjithashtu mangësinë serioze në përkthimin e dokumenteve ligjore thelbësore, përfshirë aktgjykimet dhe komentaret ligjorë në gjuhën serbe, duke krijuar pengesa për qasje efektive dhe të drejtë në drejtësi për qytetarët e komunitetit serb.

Në përfundim, IKD rekomandon ndërhyrje urgjente dhe strategjike për të adresuar këto sfida nëpërmjet rritjes së investimeve financiare, përmirësimit të kapaciteteve njerëzore dhe teknike, dhe implementimit të mekanizmave më rigorozë për sigurimin e cilësisë së përkthimeve dhe administrimit më të mirë të proceseve gjyqësore.

2. Monitorimi i seancave gjyqësore në Departamentin Special të Gjykatës Themelore në Prishtinë


2.1. Efikasiteti i gjykatës

Në Departamentin Special të Gjykatës Themelore në Prishtinë gjatë periudhës së monitoruar, në total u monitoruan 97 seanca gjyqësore në raste të ndryshme, nga të cilat 16 u shtynë, që paraqet rreth 16.5% të numrit të përgjithshëm të rasteve të monitoruara.



Grafikoni 1. Seancat e shtyra dhe të mbajtura në Departamentin Special të Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Analiza e arsyeve të shtyrjes tregon se shkaku më i shpeshtë ishte mungesa ose vonesa në përkthimin e shkresave të lëndës (13 raste). Një (1) rast tjetër u shty për shkak të mungesës së avokatëve mbrojtës ndërsa dy (2) raste u shtynë për shkak të mungesës së palëve të dëmtuara.



Grafikoni 2. Arsyet e shtyrjes së seancave në Departamentin Special të Gjykatës Themelore në Prishtinë.

2.2. Pajisja me shkresa të lëndës

Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës përcakton qartë rregullat për dorëzimin e dokumentacionit në procedurat penale, duke theksuar se dokumentet duhet të dorëzohen në mënyrë që palët të njoftohen siç duhet mbi natyrën dhe përmbajtjen e tyre¹. Pajisja e të pandehurit me shkresat e lëndës është parakusht për garantimin e të drejtës për gjykim të drejtë.

Gjatë monitorimit të zhvillimit të rasteve të ndryshme penale, u evidentuan probleme me mungesën e shkresave të lëndës për mbrojtjen dhe të akuzuarit, përfshirë, në disa raste, mungesën e përkthimeve në gjuhën serbe dhe në situata të tjera, mungesën e plotë të disa dokumenteve. Rrethana të tilla rezultuan që mbrojtja, duke përmendur mungesën e shkresave të lëndës, të kërkojë shtyrjen e seancave gjyqësore të planifikuara, çka pastaj pati ndikim në efikasitetin kohor të procedurës gjyqësore.

Si rezultat, është vërejtur se prokuroria, e obliguar paraprakisht nga gjykata që në kohë t'ia dorëzojë dokumentacionin palës tjetër, i kryen vetëm pjesërisht këto detyra dhe madje edhe jashtë afatit të përcaktuar për dorëzim të plotë të materialeve. Në këtë praktikë, problemi zgjidhet duke shtyrë afatin, pra duke caktuar datë të re apo numër ditësh brenda të cilave duhet plotësuar kërkesat paraprake të paplotësuar. Kur prokuroria pretendon se ka dorëzuar gjithë dokumentacionin, përsëri janë evidentuar raste që mbrojtja, paraqet pretendime të kundërta që ndikojnë në zvarritje procedurale.

¹ Kodi NR. 08/L-032 i Procedurës Penale, neni 239.

2.3. Ndikimi i gjuhës dhe shërbimeve të përkthimit

Për dallim nga çështja e shkresave të lëndës, monitorimi ka gjetur se nevoja për të siguruar përkthim gjatë seanca gjyqësore nuk ka qenë faktor pengues për rrjedhën normale të seancave. Në të gjitha rastet e evidentuara në Departamentin Special të Gjykatës Themelore në Prishtinë janë siguruar përkthyes, duke mundësuar zhvillimin normal të procedurave, pavarësisht dallimeve gjuhësore. Për më tepër, Gjykata Themelore në Prishtinë ka filluar zbatimin e inovacioneve në këtë drejtim. Që nga shkurti 2025, përkthimi i seancave, sipas nevojës, bëhet në mënyrë simultane nga dhoma të veçanta, ndërsa edhe publiku ka qasje të lirë në pajisjet teknike të ofruara.

Ndërsa, për sa i përket situatave lidhur me përkthimin e shkresave të lëndës, situata qëndron më ndryshe. Për ilustrim, në një proces gjyqësor të një rasti të krimeve të luftës u evidentua një rast ku avokati, gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarit, paraqiti pjesë të një deklarate, e cila, sipas materialeve të ofruara, pretendohet të ishte dhënë nga dëshmitari në faza të mëparshme të deklarimit. Megjithatë, më vonë u konstatua se një pjesë e caktuar e deklaratës nuk ekzistonte në versionin origjinal shqip, por vetëm në përkthimin serbisht. Pas identifikimit të kësaj mospërputhjeje, gjykata vendosi që kjo çështje specifike të mos trajtohet në seancë, duke sqaruar se pretendime të tilla nuk përfshihen në deklaratën origjinale.²

Nga ana tjetër, përgjatë monitorimit janë identifikuar rast kur prokuroria ka deklaruar se deklaratat e palëve dhe shkresat e tjera të lëndës u janë dorëzuar me kohë përkthyesve të gjykatës dhe se çështjet e përkthimit janë jashtë përgjegjësisë së saj të drejtpërdrejtë, duke mos marrë përsipër përgjegjësinë mbi vonesat në përkthim. Tutje, gjatë seancave të monitoruara u theksua se prokuroria dhe përkthyesit punojnë paralelisht në një numër të madh të rasteve, çka rëndon kapacitetin e këtyre shërbimeve.

Bazuar në monitorimin e seancave gjyqësore dhe deklarimin e palëve të përfshira, përkthimi i shkresave të lëndës ndonëse terminologjikisht i saktë, nuk ofron gjithnjë informacion të qartë dhe gjithëpërfshirës. Në këtë drejtim, duhet theksuar se cilësia e shërbimeve të përkthimit është e ndërlidhur drejt për së drejti me mundësinë e gëzimit efektiv të të gjitha të drejtave në një procedurë penale. Cilësia e dobët e përkthimit automatikisht ul efektivitetin e të drejtave në procedurë. Për këtë arsye, është shumë e rëndësishme që çështjes së përkthimit t'i kushtohet kujdes në mënyrë që të jetë një përkthim cilësor dhe jo vetëm një obligim formal i përmbushur.

3. Monitorimi i seancave gjyqësore në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Dega në Graçanicë


Gjatë procesit të monitorimit të seancave gjyqësore në këtë gjykatë një faktor i vërejtur është fakti se seancat gjyqësore janë mbajtur në kohë dhe pa vonesa, gjë që mund të konsiderohet si tregues i organizmit të mirë të punës në gjykatë, e që ka mundësuar zhvillimin konsistent të procedurave civile dhe penale në pajtim me standardet ligjore. Megjithëse shumë aspekte të

² Për më shumë, shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/svedok-identifikovao-milosa-pleskovica-kao-clana-grupe-napadaca-na-civilno-stanovnistvo/>

punës së gjykatës mund të vlerësohen pozitivisht, gjatë procesit të monitorimit u evidentuan edhe disa sfida.

3.1. Efikasiteti i gjykatës


Përgjatë monitorimit disa mujor në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Dega në Graçanicë, në total janë monitoruar 129 seanca gjyqësore, nga të cilat 18 u shtynë, duke përbërë rreth 14% të numrit total të seancave.



Grafikoni 3. Seancat e shtyra dhe të mbajtura në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Dega në Graçanicë.

Seancat e shtyra u evidentuan në 10 raste penale dhe 8 raste civile.

Në procedurat penale, arsyeja më e shpeshtë për shtyrje ishte dorëzimi jo i rregullt i ftesave të palëve (6 raste). Përveç kësaj, në një (1) rast, seanca u shty për shkak të vonesës së prokurorisë në dorëzimin e dosjeve, ndërsa në tri (3) raste, të pandehurit mungonin për shkak se ishin jashtë vendit.



Grafikoni 4. Arsyet e shtyrjes së seancave në Divizionin Penal të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega në Graçanicë.

Në procedurat civile, arsyet e shtyrjes ishin më të larmishme dhe kryesisht të natyrës teknike – në dy (2) raste mungonte përkthyesi, ndërsa në një (1) rast mungonin dokumente provuese. Në katër (4) raste u evidentuan çështje të lidhura me ekspertizat, ndërsa në një (1) rast seanca u shty për shkak të mungesës së ekspertit.



Grafikoni 5. Arsyet e shtyrjes së seancave në Divizionin Civil të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega në Graçanicë.

3.2. Dërgimi i shkresave

Gjatë monitorimit të drejtpërdrejtë të procedurave gjyqësore në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Dega në Graçanicë, në veçanti në rastet penale, çështja e ndryshimit të adresave të palëve në procedurë është evidentuar si problematike. Kjo problematikë ka krijuar vonesa procedurale në trajtimin e rasteve gjyqësore.

Praktikisht, monitorimi ka evidentuar se ftesat për pjesëmarrje në seancë gjyqësore dërgohen në adresa shpeshherë të panjohura ose të pasakta. Edhe pse gjykata ndërmerr masa për verifikimin e adresave përmes policisë, në shumicën e rasteve kur ftesa dërgohet në adresën që gjykata e konsideron të vlefshme, ajo kthehet me shënimin se pala nuk ndodhet në adresën e cekur ose se adresa është e panjohur.

Kjo situatë është një nga faktorët më të shpeshtë që shkaktojnë shtyrjen e seancave në divizionin penal të kësaj gjykate dhe ngadalësimin e ecurisë së rasteve.

3.3. Ndikimi i gjuhës dhe shërbimeve të përkthimit

Bazuar në monitorimin sistematik të realizuar nga IKD, mungesa e përkthyesve përbën një nga arsyet që ka çuar në shtyrjen e seancave gjyqësore.

Në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Dega në Graçanicë, është vetëm një përkthyes në dispozicion për të gjitha seancat, ndërsa gjyqtarët angazhohen në një numër të madh rastesh civile dhe penale. Për pasojë, shpeshherë është e pamundur të sigurohet përkthimi për të gjitha gjykimet brenda të njëjtës ditë, duke shkaktuar vonesa në procedura, pasi që duhet të bëhet riorganizmi i seancave. Kjo sfidë tregon qartë nevojën për përkthyes shtesë për të siguruar komunikim adekuat dhe reciprok gjatë gjyqësorëve, veçanërisht në një mjedis shumetnik.

Një sfidë tjetër lidhet me përkthimin e vendimeve gjyqësore në gjuhën e palës, gjë që, në disa raste, ka paraqitur pengesë për zgjidhjen efikase të lëndëve. Për më tepër, përkthimet jo cilësore rrezikojnë të drejtat e palëve në procedurë derisa vonesat në përkthimin e dokumenteve të nevojshme cenojnë efikasitetin procedural.

4. Mbrojtja e të drejtave gjuhësore në sistemin e drejtësisë

Përkthimi i saktë dhe në kohë i dokumenteve dhe procedurave gjyqësore është thelbësor për garantimin e të drejtave themelore të qytetarëve. Mungesa e përkthimeve cilësore ose vonesat në sigurimin e tyre mund të kenë pasoja serioze në garantimin e të drejtës për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm, duke ndikuar drejtpërdrejt në sigurinë juridike dhe barazinë para ligjit.

Në Kosovë, Kushtetuta garanton të drejtën për një proces të drejtë gjyqësor dhe njeh si gjuhën shqipe dhe serbe si gjuhë zyrtare në të gjitha nivelet e administratës dhe gjyqësorit. Ndërkaq, Kushtetuta dhe ligjet procedurale garantojnë të drejtën e përkthimit për palët të cilët nuk e flasin gjuhën në të cilën zhvillohet procedura gjyqësore. Megjithatë, në praktikë, problemi i mungesës së përkthyesve të kualifikuar apo vonesat në përkthimin e dokumenteve janë ende të shpeshta.

Ndikimi konkret i këtyre mangësive është i shumëfishtë. Në raste të caktuara, qytetarët nuk arrijnë ta kuptojnë aktakuzën ndaj tyre ose nuk kanë qasje të plotë në provat dhe arsyetimet ligjore të vendimeve, duke u penguar që të ushtrojnë mbrojtjen në mënyrë efektive. Për më tepër, përkthimet e vonuara çojnë në zvarritje të procedurave gjyqësore, duke shkaktuar shtyrjen e seancave gjyqësore siç tanimë u elaboruan në këtë raport.

4.1. Problemet në cilësinë e përkthimit

Përkthimi i shkresave të lëndës në procedurat gjyqësore nuk është vetëm një detyrim formal, por është element kyç që garanton të drejtën për një proces të drejtë dhe efikas, si dhe siguron barazinë e palëve para ligjit. Në këtë kontekst, cilësia e dobët e përkthimeve mund të shkaktojë pasoja serioze në disa nivele, duke filluar nga cenimi i të drejtave themelore, deri te komplikimet procedurale që ngadalësojnë dhe dobësojnë efikasitetin dhe besueshmërinë.

Cilësia e dobët e përkthimeve të shkresave gjyqësore sjell pasoja konkrete ligjore dhe procedurale. Në raste penale, për shembull, gabimet në përkthimin e aktakuzës, provave apo deklaratave të dëshmitarëve mund të përbëjnë bazë ligjore për apelim dhe kthim të rastit në rigjykim, duke vonuar procesin dhe duke rritur kostot e tij. Po ashtu, gabimet në përkthim mund të sjellin edhe shkelje të drejtës gjykim të drejtë dhe të drejtës në mjete efektive juridike, të cilat të drejta mbrohen nga Kushtetuta e Kosovës dhe standardet ndërkombëtare, siç është neni 6 dhe 13 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ).

Ngjashëm edhe në procedurat civile, cilësia e dobët e përkthimeve mund të shkaktojë konfuzion rreth fakteve dhe të çojë në gabime gjatë interpretimit të pretendimeve, duke shkaktuar zvarritjen e seancave dhe krijimin e hapësirës për konflikte të panevojshme procedurale.

Për të parandaluar problemet ligjore dhe procedurale që lindin nga cilësia e dobët e përkthimeve, është thelbësore që institucionet të ndërmarrin hapa konkretë. Në këtë kontekst, është jetike që të investohet në ngritjen e kapaciteteve për përkthyes gjyqësorë të certifikuar, të cilët zotërojnë njohuri të thelluara ligjore. Po ashtu, është e nevojshme që Këshilli Gjyqësor i Kosovës të vendosë mekanizma të qartë për monitorimin e cilësisë së përkthimeve, si dhe të sigurojë që përkthimi të jetë i disponueshëm dhe në përputhje me kërkesat ligjore.

4.2. Mungesa e kapaciteteve

Mungesa e përkthyesve profesionalë në sistemin gjyqësor të Kosovës përbën një nga sfidat më serioze për funksionimin efektiv dhe gjithëpërfshirës të drejtësisë, veçanërisht në kontekstin e garantimit të qasjes së barabartë për të gjithë qytetarët. Kjo mungesë është rezultat i një kombinimi faktorësh, ndër të cilët theksohet veçanërisht mungesa e buxhetit dhe kapaciteteve profesionale.

Në aspektin buxhetor, sistemi gjyqësor në Kosovë përballet me kufizime të vazhdueshme financiare, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në aftësinë për të angazhuar përkthyes të kualifikuar në mënyrë të qëndrueshme.

Përgjatë mbledhjes së 345-të të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK), është thënë nga kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë se sfida është çështja e përkthimit, duke qenë se ka mungesë, ku vetëm në Departamentin Special 40% e lëndëve kanë nevojë për përkthim, ndërsa duhet shtuar këtu edhe lëndët e vjetra që kanë nevojë për përkthim.³

Në mungesë të burimeve të mjaftueshme financiare, prioriteti shpesh i jepet angazhimeve të tjera brenda sistemit gjyqësor, ndërsa nevoja për përkthim nuk duket se ka arritur të trajtohet si çështje parësore, duke rrezikuar kështu standardet ndërkombëtare për një proces të drejtë.

Përveç aspektit financiar, është evidente edhe mungesa e kapaciteteve njerëzore. Në mbledhjen 354 të KGJK, gjyqtari mbikëqyrës i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, Shkelzen Sylaj ka deklaruar se tek njësia e përkthimeve në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, pas pensionimit të një përkthyesit kanë mbetur pa asnjë.⁴

Një pjesë e madhe e përkthyesve që zotërojnë gjuhën serbe dhe terminologjinë juridike janë tashmë të pensionuar ose në moshë të shtyrë, ndërsa brezat e rinj nuk kanë ndjekur trajnimet apo arsimin e nevojshëm në këtë gjuhë. Në sistemin arsimor të Kosovës pas luftës, gjuha serbe nuk ka pasur status si gjuhë e dytë, dhe si rrjedhojë, shumica e të rinjve zotërojnë më mirë gjuhë të tjera, si anglishtja apo gjermanishtja, por jo serbishten në nivel profesional. Kjo situatë ka krijuar një boshllëk, jo vetëm në aspektin sasior por edhe në aspektin cilësor, për sa i përket njohjes së terminologjisë ligjore dhe saktësisë në përkthim.

Për ta adresuar këtë problem në mënyrë të qëndrueshme, kërkohet një strategji afatgjatë që përfshin rritjen e investimeve në përkthim juridik, ngritjen e kapaciteteve profesionale për të rinjtë në këtë fushë, si dhe integrimin e gjuhës serbe në trajnimet për administratën dhe sistemin gjyqësor. Pa një ndërhyrje të tillë sistematike, mungesa e përkthyesve do të vazhdojë të jetë një pengesë strukturore për një drejtësi gjithëpërfshirëse në Kosovë.

4.3. Rëndësia e përkthimit të aktgjykimeve dhe komentareve

Në një shtet që synon të ndërtojë një sistem të drejtë dhe gjithëpërfshirës të drejtësisë, qasja e barabartë në informacion ligjor është thelbësore për garantimin e të drejtave të qytetarëve pa dallim gjuhe apo përkatësie etnike. Mungesa e përkthimeve cenon sigurinë juridike dhe barazinë procedurale, si dhe mund të ndikojë negativisht në besimin e komuniteteve jo-shumicë në institucionet e drejtësisë në Kosovë. Prandaj, është thelbësore që institucionet e drejtësisë në Kosovë të angazhohen në mënyrë sistematike për përkthimin cilësor dhe në kohë të aktgjykimeve të rëndësishme dhe dokumenteve udhëzuese ligjore në gjuhën serbe. Në këtë drejtim, përkthimi i aktgjykimeve të gjykatave si dhe i Komentareve në gjuhën serbe, paraqet një domosdoshmëri për sigurimin e barazisë para ligjit për komunitetin serb në Kosovë.

Numri i aktgjykimeve të publikuara në gjuhën serbe vazhdon të mbetet ende i ulët. Për më tepër, komentaret e ligjeve specifike ofrohen vetëm në gjuhën shqipe dhe vazhdimisht haset në mungesë të përkthimit të tyre në gjuhën serbe. Mungesa e aktgjykimeve dhe komentareve në

³ Për më shumë, shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/1-mije-e-553-lende-te-kryera-ne-gjykatene-themelore-ne-mitrovice-ne-tre-muajt-e-pare-te-ketij-viti-ngecje-ne-lendet-kontestimore-dhe-permbarimore/>

⁴ Ibid.

gjuhen serbe, i privon qytetarët serb dhe avokatët e tyre nga qasja e barabartë në informata sikurse qytetarët dhe avokatët që flasin shqip.⁵

Mungesa e përkthimeve të qëndrueshme dhe të sakta në gjuhën serbe krijon pengesa të mëdha për profesionistët juridikë nga komuniteti serb, për të pandehurit dhe për palët e tjera në gjyqësor. Pa qasje në dokumentet kryesore ligjore në gjuhën e tyre amtare, këta qytetarë shpeshherë përballen me vështirësi në kuptimin dhe zbatimin e dispozitave ligjore, duke u vënë në një pozitë të pafavorshme për të mbrojtur dhe ushtruar të drejtat e tyre në mënyrë efektive.

Përkthimi i dokumenteve ligjore nuk është vetëm një çështje teknike apo administrative, është një e drejtë themelore që lidhet ngushtë me shtetin e së drejtës dhe integrimin e të gjitha komuniteteve në rendin kushtetues të Kosovës. Një qasje e tillë jo vetëm që forcon parimin e barazisë para ligjit, por edhe kontribuon në një sistem drejtësie më transparent, gjithëpërfshirës dhe të orientuar drejt të drejtave të njeriut.

5. Rekomandimet

- Të sigurohet buxhet i mjaftueshëm për KGJK-në për të adresuar mungesën e përkthyesve.
- Të rriten kapacitetet e përkthimit dhe trajnimet profesionale të përkthyesve gjyqësorë.
- Të krijohet një strategji afatgjatë që përfshin rritjen e investimeve në përkthim juridik, ngritjen e kapaciteteve profesionale për të rinjtë dhe integrimin e gjuhës serbe në trajnimet për administratën dhe sistemin gjyqësor.
- Këshilli Gjyqësor i Kosovës të vendosë mekanizma të qartë për monitorimin e cilësisë së përkthimeve.
- Gjykatat të vazhdojnë të sigurohen që përkthimi të jetë i disponueshëm dhe në përputhje me kërkesat ligjore.
- Gjykatat të përmirësojnë aspektet administrative për të menaxhuar më mirë mundësitë e ndryshimeve të adresave të palëve në procedurat gjyqësore.
- Të zbatohet përkthimi sistematik dhe publikimi i aktgjykimeve në gjuhën serbe për të forcuar transparencën dhe qasjen në drejtësi.
- Të bëhet përkthimi i komentareve ligjorë në gjuhën serbe për të forcuar qasjen në drejtësi.

⁵ Raporti i Shoqërisë Civile për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2024 ([04-Report-Civil-Society-Report-on-Human-Rights-2024-ENG-04.pdf](#)), fq. 24.

